



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 44
Prishtinë, më 20 dhe 21 dhjetor 2011

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 DHE 21 DHJETOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari, deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (nga seanca e kaluar),
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësi organike,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arkivat,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parkun Kombëtar “Sharri”,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deminimin humanitar,
11. Shqyrtimi i parë i Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës,

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azilin,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht,
20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sportin,
23. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore,
24. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë,
25. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar,
26. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011,
27. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2012,
28. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
29. Shqyrtimi i Strategjisë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Rexhep Selimi, Burim Ramadani, Suzana Novoberdaliu, Emilija Rexhepi, Zenun Pajaziti, Rasim Demiri, Visar Ymeri, Time Kadrijaj dhe Donika Kadaj-Bujupi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Lutfi Haziri, parashtroi pyetje për ministrin, Ramë Buja, në lidhje me jetësimin e projektit për Universitetin Publik të Gjilanit.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetit Lutfi Haziri.

Deputeti Lutfi Haziri, parashtroi pyetje për ministrin, Slobodan Petroviç, në lidhje me planin e MAPL-së për themelimin e komunave të reja me shumicë shqiptare, e në veçanti rishikimin funksional të Aneksit III, të presidentit Ahtisari, që rregullon pushtetin lokal.

Ministri Slobodan Petroviç, iu përgjigj pyetjes së deputetit Lutfi Haziri.

Deputetja Alma Lama, parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me heqjen e TVSH-së për media.

Kryeministri Hashim Thaçi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Nazane Breca, parashtoi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me afatet për protokollet dhe udhërrëfyesit klinik, për sëmundjet më të shpeshta në kujdesin parësor shëndetësor, të mbështetura nga Banka Botërore.

Ministri, Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes, Nazane Breca.

Deputetja, Nazane Breca, parashtoi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me masat që mund të ndërmerren lidhur me specializimin e kryeinspektore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe pozitës së saj të punës.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes, Nazane Breca.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me përzgjedhjen e kompanisë furnizuese, për furnizim penj kirurgjik.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes, Time Kadrijaj.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin, Ferid Agani, në lidhje me blerjen shtesë të barnave nga lista esenciale.

Ministri Ferid Agani, iu përgjigj pyetjes së deputetes, Time Kadrijaj.

Deputetja, Kimete Bytyqi, parashtoi pyetje për ministrin, Blerand Stavileci, në lidhje me planet e ministrisë që ai drejton, për subvencionimin e vreshtarëve në mbjelljen e hardhive të reja të rrushit, me theks në Komunën e Thernadës..

Ministri Blerand Stavileci, nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për ministrin, Memeli Krasniqi, në lidhje me atë se a ka ndonjë program ministria që ai drejton për t'a ndihmuar Klubin e Atletikës”Rogana”.

Ministri Memeli Krasniqi, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Visar Ymeri.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për ministrin, Bedri Hamza, në lidhje me transferin që është dashur të bëhej në buxhetin e Kosovës të 16.2 milionë €, nga ana e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit në emër të garancës së kuzorciutit Cosmocell duke bërë ekzekutimin sipas pakos tenderuese, lidhur me licencën e dytë të Telefonisë Mobile në Kosovë.

Ministri Bedri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Visar Ymeri.

Deputeti, Liburn Aliu, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministren, Edita Tahiri, në lidhje me eliminimin e strukturave paralele serbe deri me 1 nëntor 2011, në territorin e Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Liburn Aliu.

Deputeti Afrim Kasolli, parashtoi pyetje për ministrin, Ramë Buja, në lidhje me faktin se pse deri më tani nuk është ndërmarr asgjë nga ana e MASHT-it, për ndërtimin e një objekti shkollor në fshatin Roganë, komuna e Kamenicës.

Ministri, Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Afrim Kasolli.

Deputeti Sali Morina, parashtoi pyetje për ministrin, Blerand Stavileci, në lidhje me numrin e të punësuarve në kontratë mbi vepër në Ministrinë që ai drejton dhe mënyrën e pagesës së tyre.

Ministri Blerand Stavileci, iu përgjigj pyetjes së deputetit, Sali Morina.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 7 e 8 dhjetor 2011

Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 7 e 8 dhjetor 2011, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet-komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme kanë shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012 dhe Kuvendit ia kishin paraqitur raportet me rekomandime.

Raportin e Komisionit funksional e arsyetoi kryetarja e këtij Komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Deputeti Zenun Pajaziti deklaroi se i tërheq amendamentet 53 dhe 54, që ishin mbështetur edhe nga tre deputetë të tjerë, nga rajoni i Gjilanit.

Lidhur me këtë projektligj diskutuan edhe këta deputetë: Visar Ymeri, Alma Lama, Naser Osmani dhe ministri Ferid Agani.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51 dhe 57.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet: 52, 55 dhe 56.

Amendamentet 53 dhe 54 i tërhoqi propozuesi.

Në fund, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 47,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, **Hashim Thaçi** tha se Pakoja e Ahtisarit dhe neni 8 i Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, Qendrën Historike të Prizrenit e konsiderojnë si zonë të veçantë të mbrojtur edhe për shkak të specifikave të saj.

Ky projektligj do t'i rregullojë aktivitetet brenda kësaj qendre duke ruajtur karakterin e saj kulturor, historik dhe fetar.

Me këtë Projektligji themelohet Qendra Historike e Prizrenit, menaxhimi i saj, mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, fetare dhe historike të Qendrës Historike të Prizrenit, si qytet me vlera kulturore, historike, të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar; rregullohen aktivitetet që do të ndërmerren në kuadër të kësaj qendre dhe mundësohet funksionimi i kësaj qendre kulturore dhe historike në mënyrë të papenguar, themelohet Komiteti për trashëgiminë Kulturore të Prizrenit, roli i të cilit është të mbikëqyrë dhe këshillojë rreth zhvillimit të aktiviteve në Qendrën Historike të Prizrenit, me qëllim të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të saj, themelohet Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit, detyrë e së cilës është t'i koordinojë veprimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare, promovimin dhe zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të shquar, shumetnike, nxjerrjen dhe shpërndarjen e informatave të sakta sa i përket Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat.

Ky projektligj është mënyra më e mirë për të respektuar trashëgiminë kulturore të të gjitha komuniteteve, jo vetëm atë ortodokse, por edhe krishtere e myslimane, pra të gjithë besimtarëve në Kosovë, apo trashëgiminë kulturore të gjithë qytetarëve në Republikën e Kosovës.

Në fund, kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin Qendrën Historike të Prizrenit.

Pastaj, Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, **Nait Hasani**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Adem Grabovci**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Salih Morina**, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, **Liburn Aliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar SLS, **Sasha Milosavleviq** dhe në emër të Grupit Parlamentar "6+", **Duda Balje**, si dhe deputetët: **Hydajet Hyseni**, **Eqrem Kryeziu**, **Ismet Beqiri**, **Lutfi Haziri**, **Goran Marinkoviq**, **Muhamed Mustafa**, **Rexhep Selimi**, **Emin Gërbeshi**, **Alma Lama**, **Glauk Konjufca**, **Agim Kuleta**, **Afrim Kasolli** dhe ministri **Dardan Gashi**, të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 42,
Abstenime----- 2

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësi organike

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqes dhe arsyetojë Projektligjin për bujqësinë organike.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci, tha se qëllimi kryesor i këtij projektligji është që të krijojë bazë ligjore të zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit organik, duke siguruar funksionimin efikas të tregut, konkurrencën e drejtë dhe duke mbrojtur interesat e konsumatorëve. Me këtë Projektligj synohet të arrihet stimulimi i një prodhimtarie të larmishme bujqësore, e cila u përgjigjet kërkesave të konsumatorëve duke zbatuar procese që ruajnë mjedisin, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe të kafshëve.

Në projektligj përcaktohen objektivat dhe parimet për të gjitha fazat e prodhimit të produkteve organike, mënyrat e përgatitjes, mënyrat e shpërndarjes dhe kontrollit të këtyre produkteve, si dhe mënyrat e përdorimit të indikatorëve që u referohen etiketimit të prodhimeve organike.

Projektligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në baza profesionale, për rritjen e cilësisë së prodhimit organik.

Në fund, ministri Blerand Stavileci i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për bujqësinë organike.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për bujqësinë organike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Milosavleviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për bujqësinë organike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për bujqësinë organike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arkivat

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për arkivat.

Zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi** tha se ky projektligj siguron rregullat bazë për funksionimin efektiv të shërbimit arkivor në institucionet e Kosovës, si dhe ndryshimin e disa dispozitave kundërthënëse të këtij ligji në fuqi. Projektligji për arkivat i adresohet Qeverisë dhe administratës në nivelin qendror dhe lokal, institucioneve ligjdhënëse dhe gjyqësore, Zyrës së Presidencës, Prokurorisë, personave fizikë dhe juridikë që kryejnë detyra publike apo operojnë me fonde publike, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës për të cilat përcaktohen detyrimet ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore.

Në bazë të këtij projektligji do të përcaktohen: normat, standardet dhe afatet kohore për ruajtjen, si dhe shfrytëzimin e materialit arkivor nga institucionet përkatëse. Projektligji për arkivat krijon një infrastrukturë ligjore më të avancuar, në përputhje me praktikën e vendeve të zhvilluara evropiane.

Në fund, zv. kryeministri Bujar Bukoshi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për arkivat.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për arkivat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjit për arkivat dhanë: në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Xhevahire Izmaqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Boban Todoroviq, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje dhe deputetja Salihe Mustafa, diskutimet të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për arkivat.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për bujqësinë organike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parkun Kombëtar “Sharri”

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Dardan Gashi tha se nevoja për nxjerrjen e Ligjit për Parkun Kombëtar “Sharri” është i nevojshëm për së paku dy arsye. Së pari, sepse mbrojtja adekuate e kësaj zone nuk ka qenë e mundur për shkak të mos harmonizimit të ligjit për këtë park, i miratuar në vitin 1986. me dispozitat e sotme ligjore të Republikës së Kosovës. Së dyti, për arsye se këtij parku i shtohet pjesa prej mbi 20.000 hektarë, që i përket komunës së Dragashit, me anë të së cilës hapësira e këtij parku rritet në mënyrë të ndjeshme.

Shpallja e “Sharrit” Park Kombëtar, në kuadër të legjislacionit të Republikës së Kosovës, do të krijojë bazën ligjore që kjo zonë të mbrohet, ruhet, përparohet dhe zhvillohet dhe do të jetë një bazë e fortë për zhvillimin e turizmit malor dhe investimeve në ngritjen e kapaciteteve turistike.

Projektligji është hartuar në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe standardet e Bashkimit Evropian. Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore pasi që ekziston Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, me qendër në Prizren.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afërdita Shaqiri-Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Boban Todoroviq dhe në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët Emilja Rexhepi dhe Murselj Halili, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, ministri Dardan Gashi dha sqarime lidhur me vërejtjet e deputetëve për Projektligjin për Parkun Kombëtar “Sharri” dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë projektligj.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Dardan Gashi tha se Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” veçohet si një zonë me bukuri natyrore, me florë dhe faunë të veçantë, fatkeqësisht i është nënshtruar një tendence të shkatërrimit nga ndërtimet e egra dhe prerjet ilegale të pyjeve. Andaj, me shpalljen e kësaj zone park kombëtar, është momenti i fundit që ky territor të futet në mbrojtjen e shtetit para se të dëmtohet në masë të pariparueshme.

Me miratimin e këtij ligji, Kosova do të pajiset me parkun e dytë kombëtar dhe po iu afrohet standardeve evropiane, ku shtetet obligohen që së paku 10% të territorit të tyre ta vënë në mbrojtje të tillë.

Për shkak të kufizimeve buxhetore, Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” do të menaxhohet nga Drejtoria ekzistuese e Parkut Kombëtar “Sharri” me anë të një departamenti të veçantë deri në krijimin e kushteve për një rregullim tjetër.

Projektligji në asnjë mënyrë nuk i prekë pronat private, ato vazhdojnë të mbesin të tilla.

Andaj, shqetësimet sa u përket pronave janë të panevojshme, sepse ky projektligj i vë vetëm në mbrojtje sa i përket Ligjit të natyrës, kurse prona u mbetet atyre që e posedojnë.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjit për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afërdita Shaqiri-Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Boban Todoroviq, si dhe deputeti Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin, brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deminimin humanitar

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për deminimin humanitar.

Ministri i Forcës së Sigurisë, **Agim Çeku**, tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave për deminim humanitar në Kosovë.

Çështjet që rregullon ky projektligj kanë të bëjnë me deminimin humanitar, institucionet kompetente për deminim, kushtet dhe kriteret për akreditim, suspendim dhe anulim të licencave të organizatave të cilat merren me aktivitetin e deminimit humanitar.

Projektligji precizon edhe veprimtarinë dhe kompetencat e Qendrës Koordinuese për Deminim në kuadër të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe koordinimin ndërmjet institucioneve vendore për ndërmarrjen e veprimit të dominimit.

Projektligji nuk krijon implikime financiare për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Projektligji është hartuar në bashkëpunim me këshilltarët e NATO-s dhe është në përputhshmëri me standardet IMAS.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjit për deminimin humanitar dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, në mungesë të kuoromit, deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 18:10, për të vazhduar të nesërmen në orën 10:00.

E mërkurë, më 21 dhjetor 2011 Vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e drejtoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 62 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e saj.

Kryesuesi tha se diskutimet për pikën e 10-të - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deminimin humanitar kanë përfunduar në mbledhjen e djeshme, ndërsa në mungesë të kuorumit ka mbetur pa u votuar.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Projektligjit për deminimin humanitar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për deminimin humanitar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqes dhe arsyetojë, para deputetëve të Kuvendit, Projektkodin penal të Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryeministri, **Bujar Bukoshi**, tha se ky projektkod është rezultat i angazhimit të Ministrisë së Drejtësisë, në vazhden e përmirësimit të legjislacionit penal në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, tha se Projektkodi Penal eliminon mangësitë, zbrastësitat dhe vështirësitë e evidentuara gjatë zbatimit të Kodit nga ana e institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, me theks të veçantë nga ana e gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Kosovës.

Në këtë projektkod janë përfshirë gjithashtu institute të reja të së drejtës penale, janë inkorporuar dhe sanksionuar vepra të reja penale si dhe janë bërë ndryshimet e duhura si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vazhdueshme në Republikën e Kosovës, theksoi zv. kryeministri Bukoshi.

Më tej, ai përmendi edhe ndryshimet tjera të parapara në këtë projektkod të cilat kanë të bëjnë me çështjen e dënimeve, çështjen e burgimit të përjetshëm ku si arsye bazë për një gjë të tillë është parandalimi i veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Ai, më tej u fokusua në strukturën e këtij projektkodi, i cili përbëhet nga 35 kapituj me gjithsej 442 nene.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës, nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektkod dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar

SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, deputetët: Arsim Bajrami, Alma Lama, Bekim Haxhiu si dhe zv. kryeministri, Bujar Bukoshi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektkodi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 52,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektkod në afatin e paraparë me Rregullore dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për financimin e subjekteve politike.

Raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Haderjgonaj.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5A, 6, 7, 8, 9, dhe amendamentin nr. 10.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 73,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për financimin e subjekteve politike.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndihmë juridike falas.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Arben Gashi.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, raportin e këtij komisioni e arsyetoi deputetja, Safete Hadergjonaj.

Deputeti, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim për njërën nga mbledhjet e ardhshme.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të Projektligjit për ndihmë juridike falas.

Kuvendi, me anë të një votimi formal, miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi propozimin që Projektligji për ndihmë juridike falas të shtyhet për shqyrtim për njërën nga mbledhjet e ardhshme.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për të huajt.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës ë Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, deputeti, Rexhep Selimi.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe amendamentin nr. 44.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	68,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për të huajt.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azilin

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për azilin.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës ë Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi anëtarja e këtij komisioni, deputetja, Ganimete Musliu.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, dhe amendamentin nr. 21.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	63,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për azilin.

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Zenun Pajaziti.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe amendamentin nr. 24.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	66,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Kryesuesi, i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Idriz Vehapi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Sabri Hamiti, Arben Gashi, Alma Lama, Afrim Kasolli, Lutfi Haziri, Muhamet Mustafa, Idriz Vehapi dhe Adem Grabovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të shtyhet për shqyrtim për njërën nga mbledhjet e ardhshme.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kuvendi, me anë të një votimi formal miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi propozimin që Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës të shtyhet për shqyrtim për njërën nga mbledhjet e ardhshme.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, deputeti, Armend Zemaj.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe amendamentin nr. 9.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	72,
Kundër-----	4,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Nait Hasani, i cili tha se Komisioni që ai udhëheq, sipas rekomandimeve të ekspertëve i propozon Kuvendit që Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht të mos miratohet në shqyrtim të dytë.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor që Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht të mos miratohet në shqyrtim të dytë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	shumica absolute,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.

Raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Nait Hasani.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Goran Marinković, Nait Hasani, Liburn Aliu, Lutfi Haziri dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti, Adem Grabovci, kërkoi që Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, të shtyhet për shqyrtim në njërin nga mbledhje e ardhshme.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim propozimin që Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore të shtyhet për shqyrtim në njërin nga mbledhje e ardhshme.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	36,
Kundër-----	46,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk miratoi propozimin që Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore të shtyhet për shqyrtim në njërin nga mbledhje e ardhshme.

Kryetari, në vazhdim hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, dhe 4.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	68,
Kundër-----	12,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore.

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës ë Sigurisë së Kosovës, e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, deputeti, Anton Quni.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	69,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sportin

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. L/2003-24 për sportin.

Raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti, Idriz Vehapi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti, Bekim Haxhiu.

Kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6A, 7, 8, 9A dhe 10.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	69,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. L/2003-24 për sportin.

23. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore

Deputeti **Nijazi Idrizi**, në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore dhe Kuvendit i kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij Raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur komisioni funksional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afërdita Berisha-Shaqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Sevdije Lama, si dhe deputetët; Sali Morina, Nijazi Idrizi dhe kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për tokën bujqësore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-26 për tokën bujqësore, me vërejtjet e deputetëve gjatë seancës plenare.

24. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë

Deputetja **Kimete Bajraktari**, në emër të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë, dhe Kuvendit i kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ajo u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur komisioni funksional.

Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Kurtan Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Kimete Bajraktari, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+“, Duda Balje, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, Ganimete Musliu dhe kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, i cili paraqiti vërejtjet e tij lidhur me këtë raport dhe propozoi që ato vërejtje të harmonizohen bashkë me raportin e komisionit funksional. Diskutimet e deputetëve të lartpërmendur dhe kryetarit të Kuvendit janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për liritë fetare në Kosovë, sipas vërejtjeve të paraqitura në diskutim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë, me vërejtjet e paraqitura nga deputetët gjatë diskutimit në mbledhje plenare.

25. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar

Deputeti **Arben Gashi**, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar dhe Kuvendit i kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, si dhe deputeti, Gëzim Kelmendi dhe kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi. Diskutimet e deputetëve të lartpërmendur dhe kryetarit të Kuvendit janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 55,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Miratohet raporti i Komisionit për Legjislacion, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, me vërejtjet e deputetëve gjatë diskutimit në mbledhje plenare.

26. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011

Në emër të Komisionit për Integritet Evropian, deputetja, **Vjosa Osmani** tha se ky Komision, në koordinim me komisionet tjera parlamentare, ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin e dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2011.

Në vazhdim ajo u fokusua në aspekte të veçanta të këtij raporti, ndërsa në fund ftoi deputetët për miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, Arben Gashi, Safete Hadergjonaj dhe Xhevdet Neziraj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit të dytë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Miratohet raporti i dytë i Komisionit për Integritet Evropian për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2011, me vërejtjet e deputetëve gjatë diskutimit në mbledhje plenare.

27. Shqyrtimi i Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian, për vitin 2012

Në emër të Komisionit për Integritet Evropian deputetja, **Vjosa Osmani** tha se ky Komision në bazë të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Kosovës për vitin 2011, ka përgatitur Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2012 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në vazhdim ajo u fokusua në aspekte të veçanta të këtij Plani të veprimit, ndërsa në fund ftoi deputetët për miratimin e këtij Plani..

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2012.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë plan dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Sabri Hamiti dhe Hydajet Hyseni, dhe ministrja Vlora Çitaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	68,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Planit i veprimit të Kuvendit për integritet evropian, për vitin 2012

28. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Në emër të Komisionit për Legjislacion, deputeti **Arben Gashi** tha se si komision kemi shqyrtuar propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i kemi rekomanduar emërimin e tyre, në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e rekomandimit të Komisionit për Legjislacion për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputetja Emilija Rexhepi, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Pastaj, **kryesuesi** hodhi në votim miratimin e propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

I. Anëtarë të Këshillit të Gjyqësor të Kosovës emërohen:

1. Raime Rama-Elezi, gjyqtare e Gjykatës së Qarkut në Prizren,
2. Nebojsa Boriçiç, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës,
3. Sali Mekaj, kryetar i Gjykatës së Qarkut në Pejë.

II. Mandati i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës zgjat pesë (5) vjet.

29. Shqyrtimi i strategjisë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012

Në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti tha se ky Komision ka shqyrtuar propozim-strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Në vazhdim ai u fokusua në aspekte të veçanta të propozim-strategjisë, ndërsa në fund ftoi deputetët për miratimin e saj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e propozim-strategjisë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë propozim-strategji dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostić, si dhe deputetët: Bekim Haxhiu, Visar Ymeri dhe Muhamet Mustafa, si dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që propozim-strategjia minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, të shtyhet për shqyrtim për njëhën nga mbledhjet e ardhshme.

Në vazhdim, kryesuesi kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare që të deklarohen lidhur me propozimin e GP të LDK-së, për shtyrjen e shqyrtimit të dytë të propozim-strategjisë minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Deklarimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të LDK-së, për shtyrjen e shqyrtimit të propozim-strategjisë minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 41,
Kundër----- 32,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Strategjia minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012-2025, i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripunim.

Në fund të mbledhjes, kryesuesi deklaroi të mbyllur punimet e sesionit vjeshtor 2011, ndërsa sesioni pranveror 2012 do t’i fillojë punimet në javën e tretë të muajit janar 2012.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 18:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI